



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 26.1.2014,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Feim Salihu, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Puhie Demaku, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Fisnik Ismajli, Hatixhe Latifi - Pupovci, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Lirijeta Rexhepi, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Imer Rusinofci, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviq dhe Cuneyd Ustaibo.

Munguan: Lirak Çelaj, Memli Krasniqi dhe Blerand Stavileci.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin për pikat e rendit të ditës, **Ylli Hoxha** nga Lëvizja Vetëvendosje (LV), tha se për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, kemi konstatuar se materiali i dhënë për këshilltarë, por edhe ai i prezantuar në KPF, ka qenë i mangët. Kemi kërkuar një dosje të plotë të rastit, duke u bazuar në disa prej dyshimeve të cilat i kemi ngritur në atë mbledhje. Kemi pasur përkrahjen e të gjithë anëtarëve të KPF-së, që kjo dosje të iu shpërndahet anëtarëve të Kuvendit. Fakti që nuk e kemi dosjen e plotë dhe fakti se bëhet fjalë për një prej temave bukur të dyshimta, kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, për tri pika të rendit të ditës, tha se këto janë vendime të cilat janë marrë nga qeverisja e kaluar dhe nuk janë shqyrtuar nga ekzekutivi i tanishëm, por i mbetet Kuvendit ta shqyrtojë dhe ta procedojë, sepse nuk mund ta kthejmë në një vendim që tashmë është marrë nga ekzekutivi i kaluar. Këtij materiali i mungon dokumenti nga Ministria e Financave për

vlerësimin e pronës, pra është vetëm vendimi i Këshillit të Drejtorëve të mandatit të kaluar dhe vendimi i mëhershëm i Kuvendit të Komunës.

Shekfi Gashi, përfaqësues i LDK-së, tha se është mirë që rendi i ditës të miratohet ashtu si është propozuar prej KPF-së.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar gjatë dhe është vërtetë se, në pamundësi të realizimit të projektit, nuk ka mundur të shpallet një interes i përgjithshëm. Ka qenë një vendim i Kuvendit, nuk ka qenë vendim i njëanshëm, i është dërguar Ministrisë, ku dhe është marrë pëlqimi i ligjshmërisë, andaj pajtohem edhe me propozimin e kryesuesit, por edhe të kryetarit, që kjo pikë të kompletohet me material shtesë dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Sadri Ramabaja, LV, tha se kjo është hera e tretë që kjo çështje paraqitet në Kuvend. Varësisht nga interesat e grupeve të ndryshme, kjo pikë është përpunuar dhe ka ardhur këtu. Herën e parë kur është sjellë në Kuvend, çështja ka qenë për një varg zyrash dhe ambiente pune për Kuvendin, por ka qenë i qartë kundërshtimi im, se ky veprim ishte në përputhje me interesat e grupeve të ndryshme të mafisë së ndërtimit në Prishtinë.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, tha se kur është diskutuar kjo pikë, kishim një sugjerim, pra kemi sugjeruar që kjo pronë të mos ndërrohet pa e marrë parasysh edhe njëherë problemin e objekteve kulturore, historike dhe fetare në Kosovë. Sugjerimi ynë ka qenë që ajo pronë nuk duhet të jepet me asnjë kusht për ndërtim. Meqë nuk është e kompletuar si duhet kjo lëndë, propozoj që të hiqet nga rendi i ditës dhe të kompletohet për mbledhjen e radhës.

Muhamet Selmani, përfaqësues i PDK-së, tha se në bazë të informacioneve që i kemi nga Ministria e Kulturës, pronarëve të cilët i kanë pronat vizavi me xhaminë nuk u lejohet ndërtimi dhe si rezultat i kësaj është propozuar pastaj edhe shpronësimi. Plotësisht pajtohem edhe ne që të bëhet shpronësimi, se ky shpronësim ndodh brenda parcelës së njëjtë. Fakti tjetër që na shqetëson më së shumti, është se krahas këtij vendimi, do të duhej bërë edhe një propozim për shpronësim të disa pronave që janë të bartura prej një lokacioni në lokacionet tjera, pra janë bërë shpronësime pa asnjë vlerësim.

Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, në mungesë të materialit të mjaftueshëm, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi konstatoi se kjo pikë duhet të plotësohet me material shtesë dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

U konstatua se me shumicë votash, një kundër, pika e rendit të ditës "Propozimvendimet përfundimtare për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës", shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit, me arsytim që lënda të kompletohet edhe më tej.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit;
2. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;
- 3 Propozimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
4. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
5. Caktimi i anëtarit në komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale;
6. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës AKP-së;
7. Propozimvendimi për caktimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
8. Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
9. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013 / 2014;
10. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve NPK "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë;
11. Propozimvendimi për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
12. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit komunal për siguri në bashkësi;
13. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës për përfaqësim të komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Sadri Ramabaja, LV, bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, duke thënë se do të ishte mirë që të respektohej Rregullorja e punës së Kuvendit, në mënyrë që të shënohen emrat e atyre që votojnë kundër dhe atyre që abstenojnë, meqë janë pakicë.

Kimet Zeqa, PD, bëri vërejtje në ekstrakt, e cila tha "Unë kam theksuar se në përbërjen e anëtarëve nëpër komitete të ndryshme, femra duhet të jetë e përfaqësuar barabartë, pra të paktën deri 40%, dhe jo ashtu si është cekur, se duhet të jetë vetëm një anëtare femër".

Abetare Fazliu, LB, vërejtje bëri në transkripto, duke thënë se unë e kam propozuar Brahim Mehmetaj për kryesues të Kuvendit.

Me vërejtjet e dhëna, u konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lirijeta Rexhepi, anëtare e re e Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit politikë të PDK-së, bëri betimin para Kuvendit.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimplanin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014, kryesuesi tha se grupi punues për hartimin e këtij plani është formuar nga ky kuvend.

Shefki Gashi, përfaqësues i LDK-së, në emër të grupit punues për hartimin e planit vjetor të Kuvendit të Komunës, shprehu kënaqësinë që pati gjatë punës në këtë grup, në përbërjen e të cilit ishin përfaqësuesit e të gjitha partive politike, ku shumica kanë qenë të rinj. Gjatë hartimit të këtij plani kam kërkuar që në te të përfshihet edhe një raport mujor prej policisë. Kam propozuar që pika e rendit të ditës "Pyetje dhe përgjigje", të jetë në fillim të rendit të ditës, me arsyetimin se në fund të mbledhjes po bie interesimi i anëtarëve për të qëndruar deri në fund të mbledhjes. Ky plan kryesisht është një plan global, por sigurisht se do të ndryshojë gjatë punës së Kuvendit.

Kryesuesi tha se ky është një plan orientues, por do të përpiqemi ta zbatojmë me përpikëri. Në rast se kemi ndonjë pikë me rëndësi, ne mund ta fusim në rend dite dhe ta procedojmë më tej.

Laura Zherka, PDK, në cilësinë e anëtares së grupit punues për hartimin e këtij plani, tha se, sipas këtij plani, në rend dite për mbledhjen e muajit shkurt ka qenë e paraparë edhe pika "Bartja e buxhetit prej vitit 2013 në vitin 2014". Ajo kërkoi arsyetimin se pse nuk është paraparë kjo pikë.

Kryetari sqaroi se kjo ka ndodhur për shkak se Drejtoria e Financave dhe Pronës nuk e ka marrë konfirmimin final nga Ministria e Financave, e cila e bën barazimin e llogarisë, sipas së cilës mund të bëhet bartja e saktë. Besoj se në muajin mars do të procedohet kjo pikë.

Njëzëri u miratua Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, **kryesuesi** paraprakisht i njoftoi të pranishmit rreth kërkesës së PDK-së dhe kërkesës së Shërbimit të Kuvendit, drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit për caktimin e një anëtari të PDK-së në Komitetin për Politikë dhe Financa. Lidhur me këtë, ai tha se nga Ministria e kemi marrë konfirmimin se vendimi i Kuvendit është i ligjshëm,

andaj kërkoj nga përfaqësuesi i subjektit politikë të PDK-së të na e sjellë propozimin për emrin e anëtarit të komitetit nga ky subjekt.

Lidhur me këtë çështje, **kryetari** tha se kemi kërkuar që PDK-ja ta propozojë një anëtar, por ata insistojnë që për këtë çështje të ligjshmërisë të zhvillojnë procedurat e ankimit edhe në instanca më të larta, pra duke mos e pranuar vendimin e Kuvendit.

Muhamet Selmani, përfaqësues i PDK-së, tha se në atë vendim nuk sqarohet qartë cila është metoda, apo formula që kemi ardhur deri këtu. Ne kemi kërkuar qartë në atë vendim nga Ministria e Pushtetit Lokal, që të na sqarojë se cila është formula zyrtare që bëhet për zgjedhjen e këtyre përfaqësuesve.

Sa i përket plotësimit të Komitetit për Komunitete, **Muhamet Selmani** propozoi që Laura Zherka të jetë përfaqësuese në këtë komitet.

Njëzëri u miratua Vendimi për formimin e Komiteti për Komunitete.

Pika e pestë

Lidhur me Caktimin e anëtarit, përkatësisht anëtarëve në Komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale, kryesuesi tha se Kryetari i Komunës e ka të drejtën ekskluzive që të propozojë nga një anëtar në komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale.

Për anëtarë të komisionit komunal të aksionarëve, **kryetari** dha këto propozime: Në ngrohoren e qytetit “Termokos” u propozua Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, në ndërmarrjen publike banesore, Xhelal Sveçla, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, në kompaninë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në ndërmarrjen publike lokale “Hortikultura” Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, në ndërmarrjen publike komunale “Trafiku Urban”, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, në ndërmarrjen publike komunale “Sport - Marketing” Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në Stacionin e Autobusëve, Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës.

Kryesuesi tha se emrat e propozuar nga Kryetari nuk qiten në votim.

Shefki Gashi kërkoi nga Zyra ligjore një interpretim ligjor për mos qitjen në votim të emrave të propozuar nga Kryetari.

Lidhur me kërkesën e z. Gashi, **Agim Salihu** dha sqarime të nevojshme.

Sami Hamiti, përfaqësues i LDK-së, tha se këtë temë e kemi biseduar gjatë, kemi bërë takime rreth caktimit të anëtarëve nëpër komisione të aksionarëve dhe konsideroj që ende ka nevojë të bisedohet për to, sepse ka një ndarje të thellë, dhe konsideroj që ka nevojë të ulemi dhe të bisedojmë ende për këtë çështje. GP i LDK-së propozon që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për diskutim në seancën e ardhshme.

Kryetari u shpreh se unë kam biseduar me grupet parlamentare, i kam pyetur rreth ndonjë marrëveshjeje në mes të tyre që të ndahen në mënyrë proporcionale sipas fuqisë që keni në Kuvend. GP i LDK-së nuk e ka pranuar këtë variant dhe insistimi i tyre ishte që lista me emra të qitet në Kuvend dhe të votohet.

Lidhur me këtë **Sami Hamiti** shtoi se në takime kemi biseduar, edhe atëherë subjekti politik i LV-së ka kërkuar që kjo pikë të shtyhet, pasi që ka pasur presione. Nëse kjo pikë e rendit të ditës nuk shtyhet për mbledhjen e radhës, GP i LDK-së do ta lëshojë mbledhjen.

Ylli Hoxha, përfaqësues nga LV, tha se listën të cilën ne do ta propozojmë përkrahet nga shumica, andaj propozojmë që kjo listë të votohet.

Agim Gashi, përfaqësues nga LDK-ja, e përkrahu propozimin e shefit të GP të LDK-së, duke thënë se janë arsyet interne që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

Feti Mehdiu, përfaqësues nga PD-ja, u shpreh se me gjithëpërfshirje kuptoj këtë, që të gjitha subjektet politike që kanë hyrë në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, i kanë sjellë qytetarët këtu dhe ata presin prej tyre, pra sa është mundësia që ne të përpiqemi që të mos e bllokojmë punën e administrimit, të mos e ndalim punën e qeverisjes së qytetarëve. Këto borde janë për të qeverisur disa punë këtu në Prishtinë, dhe janë formuar me qëllim që punët të shkojnë sa më mirë, të jemi sa më ekspeditiv.

Brahim Mehmetaj, përfaqësues nga LB-ja, tha se do të ishte në interes që këtë çështje ta procedojmë më tutje, ta zgjidhim çështjen dhe ta japim obligim tonë që e kemi ndaj qytetarëve.

Imer Rusinovci, përfaqësues nga AAK-ja, tha se ne jemi që të mos shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. Një person, cilido qoftë ai, nga cilido subjekt politik, i cili qëllimisht e lëshon mbledhjen në këtë takim, është përgjegjësi e tij.

Agim Salihu sqaroi se nga aspekti ligjor dhe nga dispozitat që janë në fuqi, rendi i ditës është votuar dhe duhet të procedohet më tutje.

Ylli Hoxha tha se bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale, LV, PDK, AAK, PD, LB, Partia e Fortë (PF) dhe KDTP, pas një konsulte të përbashkët, procedojmë këtë listë me emra të aksionarëve për ndërmarrjet publike: në Stacionin e autobusëve propozohet Feti Mehdiu dhe Lirie Avdiu, në NPL "Hortikultura", Sadri Ramabaja dhe Lirijeta Rexhepi, në NPL "Trafiku Urban", Fisnik Ismaili dhe Imer Rusinovci, në KRM "Pastrimi", Genc Sherifi dhe Fadil Gashi, në NPL "Sport - Marketing", Brahim Mehmetaj dhe Laura Zherka, në Ndërmarrjen Publike Banesore, Qëndron Kastrati dhe Muhamet Selman dhe në ngrohtoren e qytetit "Termokos" Hatixhe Latifi - Pupovci dhe Shaip Shabani.

Kryesuesi tha se në sallë janë të pranishëm 26 anëtarë dhe kërkoi që kjo listë të hedhet në votim.

Me 26 vota për dhe një kundër(kryesuesi), u miratua vendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës AKP-së, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se në parim jemi pajtuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, që për shfrytëzimin e pronës afati i kohëzgjatjes të përcaktohet me kushte të veçanta, që eventualisht gjashtë muaj më herët, nëse ka nevojë Komuna për atë pronë, ta ketë të drejtën e shkëputjes së kontratës.

Njëzëri u miratua Vendimi për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës AKP-së.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari tha se ky komision përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, tre (3) anëtarë caktohen nga Kryetari, tre (3) nga Kuvendi dhe një (1) caktohet nga Shoqëria civile.

Anëtarë të këtij komisioni nga Kryetari u propozuan: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit dhe Visar Berisha drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Nga Kuvendi anëtarë të këtij komisioni u propozuan:

GP i LDK-së propozoi Sokol Krasniqin, ish-drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë,

GP i LV-së propozoi Qëndron Kastratin,

GP i PDK-së propozoi Muhamet Selmanin dhe

nga Shoqëria civile u propozua Osman Bllaca, përfaqësues i organizatës IMPO.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës, Kryetari i njoftoi të pranishmit, duke thënë se këtë çështje e kam potencuar që nga fillimi i qeverisjes dhe nuk e kam ndërmend ta përdori automjetin "Audi Q 7". Këtë e arsyetoi me shpenzimet e mëdha të këtij automjeti dhe për shkak të

makinave të tjera që janë në dispozicion. Ai tha se Komuna e Prishtinës ka mjaft makina të tjera, të cilat unë dhe drejtorët mund t'i përdorim për qëllime zyrtare, dhe nuk kemi nevojë që të vozitemi me këtë makinë kaq të shtrenjtë dhe me shpenzime kaq të mëdha. Mjetet nga shitja e kësaj makine synojmë t'i transferojmë në buxhetin e subvencioneve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku kanë aplikuar për ndihmë OJQ-të, raste sociale etj.

Sami Hamiti përfaqësues nga LDK-ja, tha se këtë propozimvendim e diskutuam edhe në KPF, dhe kemi thënë se shitja e kësaj veture ka prapavijë politike. GP i LDK-së nuk do të votojë, sepse e konsideron që nuk është përfillur një procedurë e drejtë, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, kur dihet se për shitje ka edhe vetura të tjera dhe ato nuk shfrytëzohen, prandaj GP i LDK-së këtë propozimvendim nuk e voton për miratim.

Ylli Hoxha, në emër të GP të LV-së, tha se ne prej kohësh kemi kërkuar shitjen e kësaj veture, duke e konsideruar këtë si një përpjekje për ndërrim të mendësisë së lidershit, të përfaqësimit në Kuvend dhe në politikë. Konsiderojmë se simbolika e këtij akti është edhe më e rëndësishme sesa leverdia që e ka Komuna me rastin e shitjes së saj.

Laura Zherka, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e mbështesim shitjen e veturës, vetëm për shkak të qëllimit të destinimit të këtyre mjeteve. Në parim, do ta votojmë vetëm për hir të qëllimit të destinimit të këtyre mjeteve, me shpresë që në seancën e ardhshme do të kemi në ankand edhe asete të tjera të Komunës.

Mirlinda Sopi, në emër të GP të AKR-së, e mbështeti shitjen e veturës "Audi Q7", duke pasur parasysh edhe dedikimin e këtyre mjeteve për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht rastet në nevojë.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-LDD-së, e përkrahu shitjen e kësaj veture, duke pasur parasysh edhe dedikimin e mjeteve në vendin e duhur.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, gjithashtu e përkrahu miratimin e këtij vendimi, me shpresën që edhe veturat e tjera të Komunës që janë për shitje, të shiten sa më parë e të mos rrinë kot.

Ibrahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, shprehu admirim për hapin e Kryetarit për të hequr dorë nga ky privilegj, i cili është i tepërt për rrethanat në të cilat ne jetojmë. E përkrahu shitjen, por në rast se nuk merret vendim për shitjen e tij, atëherë si alternativë e dha një propozim, që kjo makinë t'i dhurohet Organizatës së Veteranëve të Luftës.

Muhamet Selmani, përfaqësues nga PDK-ja, propozoi që para se të qitet në shitje kjo veturë, t'i caktohet çmimi i shitjes prej 45.000 €, çmim i cili nuk duhet të jetë më i ulët. Njëherësh kërkoi që mjetet nga shitja e veturës, si dhe të pasurive të tjera të cilat qiten në ankand, destinimi i tyre të diskutohet dhe të votohet me shumicë votash në Kuvend, e jo që destinimi i tyre të përcaktohet nga drejtoritë përkatëse.

Ai i bëri një sugjerim edhe Kryetarit, që ta reduktojë luksin e tepërt në zyrën e tij.

Visar Arifi, nga subjekti politik i PF-së, tha se edhe ne do ta përkrahim shitjen e këtij automjeti, por edhe të të gjitha aseteve të tjera luksoze të cilat mund të jenë për momentin në posedim të Komunës. Ai njëherësh edhe shprehu interesim për blerjen e kësaj veture për subjektin e tij politik.

Sadri Ramabaja, përfaqësues nga LV-ja, bëri të ditur se ai ishte kundër edhe kur është blerë kjo veturë. Ai shprehu bindjen se të dhënat që i paraqiti Kryetari për këtë veturë, janë shfaqja më e mirë e koncepteve politike që dominonin te LDK-ja, apo ndonjë simotër e saj në rajon. Kjo veturë në fakt është shndërruar në simbol të arrogancës dhe pushtetit autoritar.

Flamur Shala, përfaqësues nga LDK-ja, shprehu mendimin se nuk është mirë që një pikë e fushatës parazgjedhore të një subjekti politik, të vijë dhe të na shkaktojë kaq probleme në një Kuvend kaq demokratik. Kemi çështje shumë më të rëndësishme se kjo, me të cilat ne duhet të merremi. Zotëri Kryetar, ju duhet të merreni me çështje të tjera, me çështje që të takojnë, me çështjen e ndërprerjes së mësimin, të cilën, po të isha unë në vendin tuaj, e kisha futur sot në rend të ditës.

Sylejman Pireva, përfaqësues nga LV, tha se kjo çështje që po debatohet është plotësisht në përputhje me vizionin dhe me konceptin e Lëvizjes Vetëvendosje, e cila gjithmonë parësore ka çështjen sociale, çështjen ekonomike, çështjen e zhvillimi etj. Kjo çështje që po debatohet, duhet të mbyllet dhe të votohet.

Kryesuesi konstatoi se në sallë ishin të pranishëm gjithsejtë 37 anëtarë të Kuvendit.

Me shumicë votash, 27 për, u miratua Vendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës.

Pika e nëntë

Lidhur me Informatën për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013/2014, të pranishmit i informoi Isuf Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

A i tha se është një shqetësim që është pasqyruar me të dhënat nga zyrtarët e drejtorisë, që ka të bëjmë me mesataren e suksesit të nxënësve. Kjo konsiderohet si një problem serioz, për shkak të numrit shumë të vogël të nxënësve nëpër shkollat e vendeve rurale dhe, në anën e tjetër, numrin shumë të madh të nxënësve nëpër shkollat urbane. Këtu mesatarja na del që është shumë në rregull, por që në fakt është një mesatare artificiale. Në këtë drejtim duhet të kemi një qasje shumë më kritike në raport me mësimin, d.m.th. me shkollën e nivelit fillor, përkatësisht nga klasa e parë deri në të pestën, për shkak se rezultatet janë skajshmërisht të fryra etj.

Agim Gashi, në emër të GP i LDK-së, tha se kur flasim për suksesin e nxënësve, duhet të shtrihemi në një analizë pak më informuese, për arsye se drejtorja ka mundur të ofrojë një informatë më komplete në këtë aspekt, në mënyrë që ne t'i shohim dallimet, të arriturat në përgjithësi në fushën e arsimit në komunën e Prishtinës. Do t'ua rikujtoj edhe dy çështje, se në informatë nuk është përfshirë niveli zero i arsimit dhe institucionet private, edhe pse këto janë pjesë integrale e sistemit të arsimit në Kosovë dhe në çdo komunë. Kësaj informate i mungojnë të dhënat për integrimin e minoriteteve, pastaj shkalla e braktisjes së mësimin nga nxënës të ndryshëm etj. Ky sukses i pasqyruar këtu në mënyrë numerike statistikore, është rezultat ose mos rezultat i disa çështjeve të tjera. Do të ishte mirë që brenda drejtorisë të sigurohen informacione, çoftë direkt nga shkollat, pra të kompletohen informatat e nevojshme, sepse kjo pastaj drejtorisë do t'i shërbente si bazë për planifikimin e ardhshëm dhe për orientimin e politikave arsimore në komunën e Prishtinës.

Sadri Ramabaja, në emër të GP të LV-së, tha se kjo është një prej pikave më të ndjeshme, për të cilën ne kemi diskutuar në këtë Kuvend, por asnjëherë nuk është sjellë informatë e mirëfilltët. Të dhënat që janë pasqyruar në këtë informatë, megjithatë janë të mjaftueshme që të mendojmë seriozisht për një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, që do t'ia kushtonim cilësisë në arsim, për të cilën kam insistuar edhe në legjislaturën e kaluar dhe mbes prapë pranë atij qëndrimi.

Rezultatet të cilat na janë ofruar këtu, sidomos në disa shkolla, janë të fryra tej mase, sepse del që katër shkolla së paku janë të shkëlqyeshme nota mesatare, gjë që nuk është e saktë. Vetëm atëherë kur do të kishim një raport të thukët, do të mund të operonim edhe me objektiva më të qarta për ngritjen e cilësisë. Do të duhej të angazhoheshin në këtë drejtim ekspertë të fushës, për të bërë një anamnezë reale.

Lirjeta Rexhepi, në emër të GP të PDK-së, tha se në Komunën e Prishtinës kemi një fakt shumë shqetësues që paraqitet dhe pasqyrohet në suksesin tonë. Janë dy çështje që duhet veçuar, e para është tendenca tradicionale e rënies së notës mesatare, që është në proporcion me rritjen e numrit të mungesave, sidomos të atyre të paarsyeshme, nga niveli fillor në atë të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë, që duhet të shqyrtohet shumë. Çështje e dytë, që është një fakt shqetësues edhe siguria në shkolla, sidomos me gjendjen dhe ndodhitë e fundit që u shfaqen. Ajo propozoi që të bëhet një monitorim përmes kamerave nëpër shkolla, jo nëpër klasa, por nëpër korridoret e shkollave, me çka edhe do të zgjidhej problemi i mungesave. Çështje tjetër që duhet veçuar është edhe fryrja e notave në shkollat fillore.

Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se në përgjithësi niveli i arsimit, në këtë rast në komunën e Prishtinës, cilësohet kryesisht i dobët dhe për këtë çështje ka shumë arsye. Infrastruktura në shkolla është e dobët, ka nevojë për përmirësime, po ashtu edhe siguria në shkolla etj. Niveli i edukimit sigurisht që

ka nevojë që të analizohet jo në mënyrë globale, por shkollë për shkollë. Ai propozoi që të shqyrtohet mundësia për rikthimin e pedagogëve të shkollave, për arsye se pedagogu apo psikologu është shumë i rëndësishëm për nxënësit. **Besa Rafuna**, në emër të GP të AAK-LDD-së, tha se kjo është një informatë që i pasqyron të dhënat e mëhershme, me disa rekomandime. Do të duhej që neve të na sillet vetëm si informatë, por nëse ajo cilësi është e dobët, atëherë të kërkohet përgjegjësi prej tyre, të monitorohet kohë pas kohe puna e mësimdhënësve etj. Shqetësues është numri i madh i mungesave, që ndikon negativisht edhe në cilësinë dhe ngritje e suksesit.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, u shpreh se e kemi pranuar si informatë, por nuk kemi arritur që të bëjmë një analizë ashtu si duhet. Ne i kemi shprehur mendimet edhe më herët, i kemi pranuar kamerat, kemi insistuar në bashkëpunimin më të madh me prindërit, me kujdestarët e klasave dhe me disa faktorë të tjerë. Kemi insistuar që inspekcioni ta bëjë punën e vet ashtu si duhet etj. Kjo është një informatë, kështu si është, me disa plotësime që do të duhej bërë, por gjithsesi të bëhet një analizë.

Mirlinda Sopi sugjeroi që të fillohet me një analizë më të thukët të këtij problemi, më të qartë dhe më të detajuar, të dihet qartë orientimi i mjeteve çoftë për ngritjen e cilësisë, çoftë për ngritjen e numrit të arsimtarëve, çoftë për ngritjen e infrastrukturës nëpër shkolla, që do të lidhej drejtpërdrejt me ngritjen e cilësisë.

Flamur Shala, përfaqësues nga LDK-ja, theksoi se kjo informatë është e përgatitur mirë, e cila pasqyron suksesin e nxënësve, mungesat etj. Megjithatë, kam pritur që ndoshta në fund të na jepej një informatë se pse u bë ndërprerja e mësimi që zgjati dy ditë, pse u ndërpre në dyzet e sa shkolla, dhe pse filloi mësimi pastaj. Shkollat tona a po ngrohen me të njëjtin naftë, me atë sasi sulfuri sa kanë pasur sipas informacioneve, dhe çka ndodhi krejt këtu, a është arsyetuar deri në fund ndërprerja e mësimi?

Ylli Hoxha, përfaqësues nga LV, u shpreh se kemi një konstatim të përgjithshëm, e ai është se kemi një cilësi bukur të brishtë të arsimit. Shumica e nxënësve kanë mungesa të theksuara, dhe në fund na del 90% sukcesi i shkëlqyeshme në shkolla të caktuara. Kjo duhet të merret shumë seriozisht dhe të bëhet një proces i auditimit për të gjithë, dhe të konstatohet pse dalin këto rezultate, ndërsa produkti final i asaj shkolle nuk del i shkëlqyeshëm. Për këtë çështje duhet të futemi në një debat të thellë.

Lidhur me ndërprerjen e mësimi për shkak të dyshimit se në naftën që përdoret për ngrohje në shkollat e komunës së Prishtinës, është gjetur përqindje e madhe e sulfurit, arsyetimin e dha **Shpend Ahmeti**.

Jusuf Thaçi dha sqarime të nevojshme rreth disa çështjeve të theksuara, të cilat ndikojnë në procesin e mbarëvajtjes së arsimit.

Me sugjerimet që në të ardhmen informatat të jenë më të kompletuar me të dhëna, u konstatua se u përkrah informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013/ 2014.

Pika e dhjetë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve NKP "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Agim Salihu.

Të gjitha grupet parlamentare u pajtuan që NKP "Trafiku Urban" t'i lejohen mjetet në shumën prej 50 000 €, për sigurimin e naftës.

Njëzëri u miratua Vendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes komunale publike "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë, në shumën prej 50 000 €, për sigurimin e naftës.

Pika e njëmbëdhjetë

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona".

Pika e dymbëdhjetë

Propozimin për themelimin e Këshillit komunal për siguri në bashkësi.

Kryesuesi theksoi se ky vendim ka mbetur të plotësohet edhe me një anëtar, me kryetarin e Këshillit të prindërve.

Jusuf Thaçi njoftoi se në momentin e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit të prindërve, do ta dërgojmë emrin e tij.

Njëzëri u miratua vendimi për themelimin e Këshillit komunal për siguri në bashkësi.

Pika e trembëdhjetë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës për përfaqësim të Komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës, kryesuesi tha se nga Kuvendi i Komunës duhet të caktohen pesë anëtarë.

Për anëtarë të Asociacionit të Komunave të Kosovës u propozuan:

Vjollca Dibra - Ibrahim, GP i LDK-së, Teuta Krasniqi, GP i LV-së, Lirije Avdiu, GP i PDK-së, Remzi Pacolli, GP i AKR-së dhe Cuneyd Ustaibo, KDTP.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për përfaqësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Pika e katërbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Feti Mehdiu, pyetje drejtuar Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale:

Qytetarët e lagjes "Matiçani", afër pompës së benzinës "Te Alia", kanë bërë kërkesë lidhur me një çështje, që ka të bëjë me bllokimin e 7- 8 shtëpive dhe 7- 8 troje nga një përrua që gjendet në atë pjesë. Sipas kërkesës, shihet se ato shtëpi janë të mbyllura dhe puna për rregullimin e përroit po zgjat tash e disa vite. Unë do ta dorëzojë në Drejtorinë e Infrastrukturës një kopje të listës poseduese dhe kopjen e planit, duke ia bashkëngjitur edhe listën e qytetarëve që janë aty, si orientim, që të shihet se ku ka ngecur ajo punë që ende nuk është kryer.

Sylejman Pireva, pyetje drejtuar Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

Institucioni të cilit unë i takoj sot mban mijëra libra në paketa, për shkak të vonesave të paarsyeshme të lëshimit të objektit të ri të bibliotekës. Kërkoj të di se kush mbanë përgjegjësinë e kësaj vonese të pajustificueshme dhe kur do të hapet ajo, në mënyrë që ato libra të kalojnë aty ku e kanë vendin.

Remzi Pacolli, pyetje drejtuar Drejtorisë së Arsimit:

Është bërë një kërkesë për emërtimin e shkollës së re në Hajvali, e cila tash për tash emërtohet "Shkolla e Re", pra deri më sot ka mbetur e paemërtuar. Lidhur me këtë, kërkoj të di nga drejtorja se deri ku ka arritur dhe si po ecën procedura.

Jusuf Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se kemi kërkuar edhe një herë fillimin e procedurave për emërtimin e saj. Shkolla, përkatësisht Këshilli i shkollës, i ka sjellë tri propozime, por njërin prej tyre e kanë fuqizuar më shumë, që ka qenë përkrahja e prindërve, dhe ne e kemi adresuar në Ministri, sepse Ministria vendos përfundimisht këtë çështje. Ne e kemi dërguar me emrin e dëshmorit që ata e kanë propozuar dhe tash jemi duke pritur miratimin, përkatësisht vendimin prej Ministrisë për emërtimin e shkollës.

Pika e pesëmbëdhjetë Të ndryshme

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit rreth një formulari, duke cekur se secili zyrtar publik, duke i përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit, jemi të detyruar që në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga sot e tutje, t'i dërgojmë deklaratat për pasuri.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, paraqiti një informatë rreth ujësjellësit rajonal "Prishtina". Ai tha se ujësjellësi rajonal "Prishtina" ka kërkuar që të lirohet nga taksat e punës, meqë janë në një investim të përbashkët me fabrikën e ujit në Shkabaj.

Së bashku me Zyrën ligjore të Komunës së Prishtinës, jemi duke i shikuar mundësitë ligjore që të mos e ngarkojmë ujësjellësin rajonal "Prishtina" me këto taksa të punës.

Sami Hamiti shtroi për diskutim edhe çështjen e ndërmarrjes "Termokos", duke thënë se duhet të analizohet mirë nga Kryetari dhe ekzekutivi çështja e kalimit të

servituteve të rrjetit që vjen për Prishtinë, dhe në pjesët që kalon nëpër prona komunale të mos i ngarkojmë, ndërsa për pronat që janë publike apo shoqërore Qeveria nuk ka kërkuar asgjë, d.m.th. është në interesin tonë, në interes të qytetarëve. Konsideroj se është e arsyeshme t'i dilet në ndihmë "Termokosit" rreth pjesës së kalimit të servituteve, sepse është një projekt, i cili besoj se edhe ne që po themi se është mirë, por edhe ju që doni ta vazhdoni, është në interes të qytetarëve, andaj duhet ndihmuar deri në përfundim.

Agim Salihu tha se kompania rajonale e ujësjellësit "Prishtina" ka kërkuar që të bëhet lirimi nga taksat. Qëllimi është që ne ta gjejmë një gjuhë të përbashkët që procesi të vazhdohet, sepse edhe në marrëveshje që është nënshkruar, është thënë që të bëhet lirimi nga taksat, do të thotë që kjo të procedohet më shpejt.

Lidhur me çështjen e projektit të kogjenerimit për ngrohoren e qytetit "Termokos", **Dardan Sejdiu** tha se këtë temë jemi duke e trajtuar me ekzekutivin, që kjo ndërmarrje të mos ngarkohet me taksën e servituteve.

Njëzëri u miratua Vendimi, me të cilin kompania rajonale e ujësjellësit "Prishtina" lirohet nga tarifat për vendosjen e tubave të ujit.

Muhamet Selmani shfaqti shpresën se pas këtij vendimi do të kemi një përshkrim më detal, pra para se të protokollohet si diçka zyrtare, do të ishte mirë që ky vendim të na dërgohet për shqyrtim.

Mbledhja mbaroi në orën 14:10.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.